VENDIM
Nr. 38, datë 25.7.2013

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese
Vladimir Kristo	anëtar i “ “
Xhezair Zaganjori	anëtar i “ “
Vitore Tusha	anëtare e “ “
Sokol Berberi	anëtar i “ “
Altina Xhoxhaj	anëtare e “ “
Fatmir Hoxha	anëtar i “ “
Admir Thanza	anëtar i “ “

me sekretare Edmira Babaj, në datën 7.2.2013, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen nr. 55/27 Akti, që i përket:

KËRKUESE: Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Shqipërisë, Këshilli i Ministrave

OBJEKTI: Shfuqizimi, si i papajtueshëm me nenet 16/2, 29/1 dhe 81/2, pika “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë”;

Shpallja e neneve 186 dhe 135 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë si të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 124, 131, germa “a”, 134, germa “d”, 145, pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 27, 28, 29, 30 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Admir Thanza, mori në shqyrtim parashtrimet me shkrim të subjektit kërkues dhe subjektit të interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, dhe pasi bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Mbështetur në aktet ndodhur në dosjet gjyqësore, rezulton se përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër (kërkuesja) janë sjellë për gjykim tri çështje penale në ngarkim të disa personave juridikë dhe disa personave fizikë.

2. Këta persona janë akuzuar për kryerjen e veprave penale të vjedhjes duke shpërdoruar detyrën (parashikuar nga neni 135 i Kodit Penal), mashtrimit (parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal) dhe falsifikimit të dokumenteve (parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal).

3. Kërkuesja, në mbështetje të neneve 134/1, shkronja “d”, dhe 145/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i është drejtuar me tri kërkesa Gjykatës Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin tërësisht të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 “Për përgjegjësinë penale të personave juridikë” (referuar si ligji nr. 9754), si të papajtueshëm me nenet 16/2, 29/1, 81/2, pika “d” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shpalljen e neneve 186 dhe 135 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, si të papajtueshëm me nenin 17/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

4. Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në mbështetje të nenit 1 pika 2 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, në lidhje me nenin 92 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), meqenëse kërkesat kanë lidhje dhe objekti është i njëjtë, vendosi bashkimin dhe shqyrtimin e tyre në një çështje të vetme.

II
Pretendimet parashtruar Gjykatës Kushtetuese

5. ***Gjykata referuese***, në kërkesat drejtuar Gjykatës Kushtetuese, parashtroi pretendime që mund të përmblidhen si vijon:

5.1 Ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë" duhet të shpallet tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën, për shkak se bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës. Ky ligj është i papajtueshëm me nenet 4, 16/2, 29/1, 81/2, pika "d" të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi është miratuar me shumicë të thjeshtë, ndërkohë që duhej miratuar me shumicë të cilësuar.

5.2 Nenet 186 dhe 135 të Kodit Penal janë të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës, pasi parashikojnë për të njëjtën vepër penale dy dënime kryesore. Këto dispozita krijojnë një ndështkim i cili nuk është proporcional në raport me rëndësinë e shkeljes konkrete dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj.

6. ***Subjekti i interesuar***, Kuvendi i Shqipërisë, parashtroi në mënyrë të përmbledhur këto prapësime:

6.1 Kërkuesja nuk legjitimohet, pasi nuk provon ekzistencën e lidhjes së drejtpërdrejtë ndërmjet dispozitave objekt kërkese dhe çështjes konkrete, si dhe nuk ka parashtruar arsye serioze për jokushtetutshmërinë e këtyre dispozitave. Rezulton nga vendimet e kërkueses se ajo, përpara se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, nuk është përpjekur aspak të interpretojë, në përputhje me Kushtetutën, dispozitat objekt kërkese. Kërkuesja, në fakt, nuk kundërshton përmbajtjen e këtyre dispozitave, por nenet 1/a dhe 45 të Kodit Penal.

6.2 Ligji nr. 9754 është miratuar në zbatim të një delegimi të bërë nga dispozitat përkatëse të Kodit Penal, të cilat janë miratuar me shumicë të cilësuar nga Kuvendi.

6.3 Ligji nr. 9754, edhe pse është një ligj që mund të miratohet me shumicë të thjeshtë, në fakt, është miratuar në Kuvend me konsensusin e të gjitha forcave politike. Prandaj, në praktikë ky ligj ka marrë votat e një ligji që kërkon shumicë të cilësuar.

6.4 Nenet 186 dhe 135 të Kodit Penal janë në përputhje me parashikimet e nenit 7 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut dhe të nenit 17 të Kushtetutës.

6.5 Nenet e sipërcituara dhe Kodi Penal janë të frymëzuar nga parashikimet e kodeve penale të vendeve të tjera, si Italia apo Franca.

7. ***Subjekti i interesuar***, Këshilli i Ministrave, nuk paraqiti parashtrime.

III
Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

1. Mbi legjitimimin e kërkueses

8. Subjekti i interesuar, Kuvendi i Shqipërisë, ka ngritur pretendimin se kërkuesja nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në lidhje me kërkimin për papajtueshmëri me Kushtetutën të akteve ligjore përkatëse, objekt shqyrtimi.

9. Çështjen e legjitimimit (*locus standi)* Gjykata e ka vlerësuar si një ndër aspektet kryesore që lidhen me inicimin e një procesi kushtetues. Kërkesa për kontroll incidental, që përbën mjetin e aksesit të gjykatës së juridiksionit të zakonshëm në gjykimin kushtetues, rregullohet nga neni 145/2 i Kushtetutës sipas të cilit, kur gjyqtarët çmojnë se ligjet vijnë në kundërshtim me Kushtetutën, nuk i zbatojnë ato, por pezullojnë gjykimin dhe ia dërgojnë çështjen kësaj Gjykate, për t'u shprehur në lidhje me kushtetutshmërinë e tyre.

10. Përmbajtja e dispozitës kushtetuese është konkretizuar nga neni 68 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", i cili përcakton disa kushte, të cilat duhet të respektohen nga gjykata referuese për të iniciuar gjykimin incidental: *së pari*, gjatë një procesi gjyqësor ajo duhet të përcaktojë/identifikojë ligjin që zbatohet për zgjidhjen e çështjes konkrete (lidhjen e drejtpërdrejtë); *së dyti*, duhet të parashtrojë arsye serioze për

jokushtetutshmërinë e ligjit ose dispozitave të tij, duke referuar në normat ose parimet konkrete të Kushtetutës. Para marrjes së vendimit të pezullimit të çështjes, gjykata referuese duhet të arrijë në përfundimin se gjykimi që ka nisur nuk mund të përfundojë pa i dhënë përgjigje çështjes së kushtetutshmërisë së ligjit nga ana e Gjykatës Kushtetuese. Në të kundërt, nëse gjykata referuese çmon se një ligj nuk do të zbatohet nga ana e saj për zgjidhjen e çështjes, edhe pse sipas saj vlerësohet si jokushtetues, ajo duhet të vazhdojë me gjykimin e çështjes (*shih vendimet nr. 6, datë 17.2.2012; nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 2, datë 3.2.2010; nr. 13, datë 4.5.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

11. Në rastin konkret, Gjykata çmon se gjykata referuese, për sa i takon pretendimit për antikushtetutshmëri të ligjit nr. 9754, objekt shqyrtimi, i ka plotësuar kërkesat si më sipër, duke identifikuar ligjin e zbatueshëm, lidhjen e drejtpërdrejtë midis dispozitave ligjore që kundërshtohen dhe zgjidhjes së mosmarrëveshjes së themelit, si dhe duke parashtruar arsyet për jokushtetutshmërinë e ligjit, referuar në normat dhe parimet konkrete të Kushtetutës. Rrjedhimisht, ajo legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës në lidhje me kërkimin për kontroll incidental të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë", objekt shqyrtimi.

12. Kërkuesja ngre gjithashtu pretendimin se nenet 186 dhe 135 të Kodit Penal janë të papajtueshme me nenin 17/1 të Kushtetutës, pasi parashikojnë për të njëjtën vepër penale dy dënime kryesore. Dënimi me burgim dhe dënimi me gjobë janë dënime kryesore, në thelb të ndryshëm nga njëri tjetri, pasi qëllimi i dënimit me burgim është diametralisht i kundërt nga ai i dënimit me gjobë. Këto dispozita krijojnë një ndështkim i cili nuk është proporcional në raport me rëndësinë e shkeljes konkrete dhe me pasojat e mundshme që mund të vijnë prej saj.

13. Gjykata vëren se ky pretendim i kërkueses është i mbështetur në vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, në të cilin Gjykata shqyrtoi një pretendim të ngjashëm. Gjykata gjen me vend të ritheksojë se vendimet e saj kanë fuqi detyruese të përgjithshme dhe janë përfundimtare. Ato përbëjnë jurisprudencë kushtetuese dhe, për rrjedhojë, kanë efektet e forcës së ligjit. (...) Për vetë faktin se norma kushtetuese bëhet realitet gjatë interpretimit, pra gjatë procesit vendimmarrës të Gjykatës, e bën këtë të fundit pa diskutim burim të së drejtës, duke pasur parasysh se neni 4 i Kushtetutës parashikon se Kushtetuta është ligji më i lartë në Republikën e Shqipërisë *(shih vendimin nr. 5, datë 7.2.2001, si dhe vendimin nr. 20, datë 1.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

14. Në vendimin nr. 47, datë 26.7.2012, Gjykata, pasi ka konstatuar se është plotësimi që iu bë nenit 29 të Kodit Penal nga ligjvënësi me ligjin nr. 9086, datë 19.6.2003, lidhur me parashikimin njëkohësisht të dënimit me burgim dhe atij me gjobë, që ka shërbyer si bazë ligjore për të gjitha ndryshimet e ndërmarra më vonë në Pjesën e Posaçme të Kodit Penal për parashikimin e dy dënimeve kryesore në vepra të ndryshme penale, e ka shfuqizuar atë, për shkak se vjen në kundërshtim me nenin 17/1 të Kushtetutës. Sipas vlerësimit të Gjykatës, përcaktimi paraprakisht nga ligjvënësi i dënimit me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me heqje lirie, në një sërë dispozitash penale, ndërhyn në atributet ekskluzive të gjykatës lidhur me caktimin në rastin konkret të dënimit. Parimi i proporcionalitetit duhet të përshkojë politikën e ligjvënësit në përcaktimin e dënimeve penale dhe, në këtë këndvështrim, përcaktimi *a priori* i dy dënimeve kryesore me ligj, nuk është proporcional.

15. Për pasojë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, gjatë shqyrtimit konkret të veprave penale, për shkak të deklarimit si antikushtetues të nenit 29, paragrafi i fundit i Kodit Penal, nga Gjykata Kushtetuese, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore, në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal. Në këto raste, gjykatat duhet të aplikojnë vetëm dënimin me burgim dhe, nëse plotësohen kushtet e sanksionuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të Kodit Penal, gjykata, në bazë të vlerësimit konkret të rrethanave të çështjes, mund të aplikojë krahas dënimit me burgim edhe dënimin me gjobë, kur vepra penale passjell përfitime materiale për autorin e saj. Gjykata, po ashtu, thekson se neni 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë, i Kodit Penal aplikohet si në rastet kur dispozitat e Kodit Penal përcaktojnë si dënim për veprën penale vetëm atë me burgim, ashtu dhe në rastet kur ato (dispozitat) sanksionojnë njëkohësisht dy dënime kryesore.

16. Në rastin objekt shqyrtimi, gjykata referuese, për veprat penale të vjedhjes, të kryer duke

shpërdoruar detyrën, dhe falsifikimit të dokumenteve, të sanksionuara në nenet 135 dhe 186 të Kodit Penal, në interpretim të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të kësaj Gjykate, duhet të zbatojë vetëm dënimin me burgim si dënim kryesor dhe sipas diskrecionit të saj, nëse plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të Kodit Penal edhe dënimin me gjobë. Për rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i gjykatës referuese se pa u shqyrtuar më parë kushtetutshmëria e neneve 135 dhe 186 të Kodit Penal, ajo nuk mund të zgjidhë çështjen konkrete.

17. Si përfundim, Gjykata vlerëson se gjykatat e juridiksionit të zakonshëm kanë të gjitha mundësitë, me parashikimet aktuale të Kodit Penal, të japin dënimin me burgim si dënim kryesor, në të gjitha rastet e përcaktimit të dy dënimeve kryesore në dispozitat e Pjesës së Posaçme të Kodit Penal, si dhe ta ashpërsojnë atë me dënimin me gjobë kur plotësohen kriteret e parashikuara në nenin 34, paragrafi i pestë dhe i gjashtë të Kodit Penal.

18. Për sa më sipër, Gjykata çmon se gjykata referuese nuk legjitimohet për të kërkuar shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të neneve 135 dhe 186 të Kodit Penal, në pjesën që parashikojnë dy dënime kryesore.

2. Mbi mospajtimin me Kushtetutën të ligjit nr. 9754, datë 14.6.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë"

19. Gjykata referuese pretendon se ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë" duhet të shpallet tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën, për shkak se bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës. Sipas kërkueses, ky ligj është i papajtueshëm me nenet 4, 16/2, 29/1, 81/2, pika "d" të Kushtetutës së Shqipërisë, pasi është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me shumicë të thjeshtë, ndërkohë që duhej miratuar me një shumicë të cilësuar prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

20. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë, që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale, jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81, pika 2 i Kushtetutës *(shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 5.2.2010)*.

21. Mbështetur në standardet e mësipërme kushtetuese, Gjykata vëren, fillimisht, se përgjegjësia penale e personave juridikë përcaktohet në një dispozitë e cila është në përputhje me këto standarde. Konkretisht, kjo përgjegjësi përcaktohet nga Kodi Penal, në nenin 45, sipas të cilit "*Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre*". Më tej, përgjegjësia penale e personave juridikë angazhohet vetëm për veprat e parashikuara po në Kodin Penal. Në këto kushte, Gjykata vëren se me ligjin objekt kërkese ligjvënësi, në zbatim të paragrafit të katërt të nenit 45 të sipërpërmendur, është kufizuar vetëm në rregullimin e llojit dhe masës së dënimit që duhet zbatuar për personat juridikë, pa ndërhyrë në parashikimet e Kodit Penal që përcaktojnë përgjegjësinë penale të kësaj kategorie personash dhe pa krijuar ndonjë vepër të re penale që duhet zbatuar ndaj tyre.

22. Ligji objekt kërkese është miratuar në zbatim të paragrafit të parë të nenit 78 të Kushtetutës, sipas të cilit "*Kuvendi vendos me shumicën e votave, në prani të më shumë se gjysmës së të gjithë anëtarëve të tij, përveç rasteve kur Kushtetuta parashikon një shumicë të cilësuar*". Gjykata referuese pretendon se ky ligj, për shkak të ndërhyrjes në legjislacionin penal, nuk duhej miratuar në zbatim të dispozitës së sipërcituar kushtetuese, por të nenit 81, paragrafi i dytë të Kushtetutës sipas të cilit kodet miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Në themel të pretendimit të saj gjykata referuese vendos argumentin se ligji objekt kërkese është antikushtetues, për shkak se nuk është miratuar nga Kuvendi me një shumicë prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

23. Sipas rregullit të përgjithshëm, organet kolegjiale e ushtrojnë veprimtarinë e tyre me praninë e të gjithë anëtarëve, por edhe me një anëtarësi më të pakët në numër. Në aktet e krijimit të tyre

përcaktohen rregulla që kanë të bëjnë me numrin e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm, të cilët autorizohen për të vepruar në emër të organit kolegjial. Numri minimal i anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm dhe që autorizohen për të vepruar në emër të organit quhet kuorum (përveç rastit kur një numri më të vogël i është dhënë kompetenca nga vetë organi ose kur një numër më i madh kërkohet veçanërisht). Kuorumi vendoset për të përcaktuar numrin minimal ose përqindjen e anëtarëve që duhet të jenë të pranishëm në çdo vendimmarrje të organit dhe që kanë autoritetin (autorizohen) për të marrë vendim në emër të të gjithë anëtarëve (*shih vendimin nr. 29, datë 21.10.2009 të Gjykatës Kushtetuese).*

24. Kushtetuta, në nenin 75/2, sanksionon se: "*Kuvendi organizohet dhe funksionon sipas rregullores së miratuar nga shumica e të gjithë anëtarëve*". Nisur nga rregullimi që përmban kjo normë kushtetuese, dhe më parë Gjykata ka theksuar se Rregullorja e Kuvendit është një akt që disiplinon procedurën për zhvillimin e punimeve të Kuvendit, organizimin e brendshëm, raportet midis vetë Kuvendit si tërësi e organizmave të tij të brendshëm, raportet e tij me organet e tjera kushtetuese etj. Një pjesë e dispozitave të Rregullores janë në përmbajtje të njëjta me dispozitat kushtetuese, ndërsa disa të tjera janë norma ekzekutive të normave kushtetuese, që përcaktojnë rregullat se si vihen në jetë normat kushtetuese. Kuvendi është organi, që me rregullore, interpreton jo vetëm normat kushtetuese, por edhe normat e tjera të rregullores së tij në praktikën e rasteve konkrete (*shih vendimin nr. 21, datë 1.10.2008 të Gjykatës Kushtetuese).*

25. Mbështetur në normat e mësipërme kushtetuese dhe në Rregulloren e Kuvendit të Shqipërisë, Gjykata vëren se Kuvendi, në miratimin e ligjit objekt kërkese, pavarësisht se formalisht është mbështetur në nenin 78 të Kushtetutës, ka ndjekur të njëjtën procedurë parlamentare në të cilën kalojnë ligjet që miratohen në bazë të nenit 81 të Kushtetutës. Në këto kushte, Gjykata vlerëson se në çështjen konkrete kontrolli i saj duhet të shtrihet në shqyrtimin nëse Kuvendi, në miratimin e ligjit objekt kërkese, ka respektuar kuorumin dhe shumicën prej tri të pestave të anëtarëve të tij, kërkuar nga neni 81, paragrafi i dytë, i Kushtetutës.

26. Mbështetur në prapësimet dhe aktet paraqitur nga subjekti i interesuar, Gjykata vëren se Kuvendi, në miratimin e ligjit objekt kërkese, ka plotësuar kuorumin dhe shumicën e domosdoshme kushtetuese prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

27. Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkueses është i pabazuar dhe, si i tillë, duhet rrëzuar.

28. Për sa më sipër, Gjykata arrin në përfundimin se gjykata referuese nuk legjitimohet në paraqitjen e një prej pretendimeve të saj, ndërsa pretendimi tjetër është i pabazuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 145/2 të Kushtetutës, si dhe të neneve 72 dhe vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë", me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.[1]

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë pro: Bashkim Dedja (kryetar), Vladimir Kristo, Altina Xhoxhaj, Vitore Tusha, Admir Thanza

Anëtarë kundër: Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi, Fatmir Hoxha

[1] Gjyqtarët Xhezair Zaganjori, Sokol Berberi dhe Fatmir Hoxha janë pjesërisht kundër. Këta gjyqtarë votuan *pro* pranimit të pretendimit se ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë" nuk është miratuar me shumicën e duhur.

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin qëndrim me shumicën, lidhur me përfundimin e arritur në këtë çështje dhe argumentet mbi të cilat mbështetet ky qëndrim, e çmoj të rëndësishme të dal me mendim pakice.

Nëpërmjet arsyetimit të saj, shumica ka konkluduar se ligji 9754/2007, rregullon vetëm disa aspekte të përgjegjësisë penale dhe nuk bie ndesh me nenin 81/2 të Kushtetutës, pasi Kuvendi, në miratimin e tij, ka plotësuar kuorumin dhe shumicën e domosdoshme prej tri të pestave (3/5) të të gjithë anëtarëve të tij, që kërkon Kushtetuta. Për pretendimin e papajtueshmërisë së dispozitave të KP-së (nenet 135 dhe 186) me Kushtetutën, shumica ka mbajtur qëndrimin se gjykata referuese nuk legjitimohet t'i drejtohet Gjykatës, sepse ajo mund ta zgjidhte çështjen konkrete mbi bazën e parashikimeve aktuale të KP-së dhe interpretimit të vendimit nr. 47, datë 26.7.2012 të Gjykatës Kushtetuese ("vendimi nr. 47/2012").

Nuk pajtohem me këto përfundime, ndaj në vijim do të parashtroj argumentet për qëndrimin tim të ndryshëm nga ai i shumicës, veçmas për secilin pretendim.

A. Për pretendimin e papajtueshmërisë së ligjit, objekt shqyrtimi, me nenin 81/2 të Kushtetutës

Shumica, në çështjen konkrete, ka arsyetuar se ligji, objekt kërkese, në zbatim të nenit 45/4, është kufizuar vetëm në rregullimin e llojit dhe masës së dënimit që duhet zbatuar për personat juridikë, pa ndërhyrë në parashikimet e KP-së që përcaktojnë përgjegjësinë penale të kësaj kategorie personash dhe pa krijuar ndonjë vepër të re penale që i duhet zbatuar atyre *(paragrafi 21 i vendimit).* Më tej, pasi ka konstatuar se Kuvendi, në miratimin e ligjit 9754/2007, pavarësisht se formalisht është mbështetur në nenin 78 të Kushtetutës, ka ndjekur të njëjtën procedurë parlamentare në të cilën kalojnë ligjet që miratohen në bazë të nenit 81 të Kushtetutës, shumica ka vlerësuar se Kuvendi në rastin konkret e ka plotësuar kuorumin e domosdoshëm prej tri të pestash që kërkon Kushtetuta (*paragrafët 25-26 të vendimit*). Si rrjedhim, shumica e ka vlerësuar si të pabazuar këtë pretendim. Nuk jam dakord me këtë përfundim të shumicës.

Gjykata, në jurisprudencën e saj, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t'i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese *(shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* Aktet juridike, që nxirren nga këto organe, duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material (*vendimi nr. 23, datë 8.6.2011 i Gjykatës Kushtetuese*).

Gjykata ka tashmë një praktikë të konsoliduar për respektimin e kritereve formale dhe materiale që vendos Kushtetuta, të cilat duhen respektuar gjatë procedurës ligjvënëse. Një nga kriteret është edhe miratimi i një ligji që kërkon shumicë të cilësuar, në respektim të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës *(shih vendimet nr. 25, datë 5.12.2008 dhe nr. 19, datë 3.5.2007 të Gjykatës Kushtetuese).* Në nenin 81, pika 2 të Kushtetutës parashikohet një listë e ligjeve, të cilat duhet të miratohen me tri të pestat e të gjithë anëtarëve të Kuvendit. Marrëdhëniet midis ligjeve të miratuara me shumicë të cilësuar dhe ligjeve të zakonshme, mund të shihen në dy mënyra të ndryshme: si marrëdhënie midis burimeve të së drejtës, të vendosura në nivele të ndryshme në hierarkinë e normave, ose si një marrëdhënie e bazuar mbi parimin e shpërndarjes së kompetencave *(vendimi nr. 9, datë 23.3.2010 i Gjykatës Kushtetuese).* Nga pikëpamja e burimeve të së drejtës, ligjet e miratuara me shumicë të cilësuar qëndrojnë më lart se ligjet e zakonshme, ndaj, në këtë aspekt, ligjet e zakonshme nuk mund të trajtojnë çështje që janë parashikuar të trajtohen nga kodet apo ligjet organike. Nisur edhe nga një interpretim historik e teleologjik i nenit 81/2, hartuesit e Kushtetutës kanë synuar që një kategori ligjesh, për shkak të rëndësisë të tyre, të miratoheshin nga Kuvendi me shumicë të cilësuar, së pari, për t'i bërë ato sa më të qëndrueshme dhe, së dyti, për të shmangur mundësinë që forca politike, që do të kishte shumicën, të cenonte parime themelore për funksionimin e një shoqërie demokratike *(shih "Debati kushtetues 1" f. 298 e në vijim, referuar në vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese).*

Në këndvështrimin formal, neni 81/2 i Kushtetutës kërkon që ligjet e përcaktuara shprehimisht në këtë nen, në preambulën e tyre, të bazohen pikërisht në këtë dispozitë të Kushtetutës. Referenca në preambul tregon se propozuesi/iniciatori i këtyre lloj projektligjesh e ka pasur parasysh që projektligji

konkret, për shkak të rëndësisë së tij, ndjek një procedurë miratimi të veçantë në raport me ligjet e tjera. Gjithashtu, referenca në këtë nen i informon dhe i tërheq vëmendjen deputetëve, që në fillim të procesit ligjvënës, se projektligji që është në proces shqyrtimi kërkon shumicë të cilësuar dhe rrjedhimisht, edhe procedura që do të ndiqet duhet të respektojë kërkesat e nenit 81/2 të Kushtetutës. Në rastin konkret, preambula e ligjit nuk referon në nenin 81/2, por në nenin 78 të Kushtetutës.

Referimi te neni 81/2 i Kushtetutës është, gjithashtu, një garanci për të ardhmen, pasi shmang rrezikun që ndryshimet e mundshme të ligjit të bëhen me shumicë të thjeshtë, sipas procedurës së parashikuar në nenin 78 të Kushtetutës, të referuar në preambul, ndërkohë që duhen bërë me shumicë të cilësuar, bazuar në kriteret që përcakton neni 81/2 i Kushtetutës.

Gjykata ka theksuar se legjislacioni penal ka për detyrë të mbrojë vlera të rëndësishme të tilla si pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e tij territoriale, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën etj. (*neni 1/b i Kodit Penal*). Ky legjislacion është një tregues kuptimplotë për çdo vend, në kuptimin se sa ai është në gjendje të balancojë të drejtën e shtetit për të siguruar rendin publik e shoqëror nga njëra anë, me të drejtat dhe liritë e individit nga ana tjetër. Në vlerësimin e Gjykatës kjo është, gjithashtu, një arsye tjetër që e ka detyruar kushtetutëbërësin të kërkojë një konsensus më të gjerë nga forcat politike të përfaqësuara në Kuvend, me qëllim që sanksionet penale të parashikohen vetëm për ato lloj veprimesh ose mosveprimesh, të cilat, në përputhje me parimin e proporcionalitetit, të jenë të krahasueshme për nga rëndësia me vlerat që mbrojnë (*shih vendimin nr. 1, datë 12.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese).* Siç ka pohuar edhe shumica, dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81, pika 2 të Kushtetutës *(shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2010 të Gjykatës Kushtetuese)*.

Nga ana tjetër, në rastin konkret, neni 45/4 i KP-së parashikon shprehimisht se: "Veprat penale dhe *masat ndëshkuese përkatëse*, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë".

Në vështrim të jurisprudencës së mësipërme dhe interpretimit të nenit 45/4 të KP-së, është e qartë se veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, duhet të rregullohen me një ligj të miratuar me shumicë të cilësuar. Veprat penale nuk mund të konceptohen e të trajtohen të ndara nga masat ndëshkuese që jepen për to (dënimet penale), pasi kështu do të humbiste qëllimi i legjislacionit penal. Dënimi penal është masë shtrënguese që zbatohet nga shteti nëpërmjet gjykatave, në bazë të ligjit, kundër personave fajtorë që kanë kryer veprën penale. Për shkak të pasojave që prodhon, dënimi penal prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, ndaj, vlerësoj se, edhe në rastet e parashikimeve ligjore të masave ndëshkuese penale të miratuara jashtë KP-së, si në çështjen konkrete, duhet respektuar shumica e cilësuar, në përputhje me nenin 81/2 të Kushtetutës. Aq më tepër rëndësi merr respektimi i kriterit kushtetues "shumicë e cilësuar", kur bëhet fjalë për dispozita ligjore jashtë KP-së, duke qenë se në këto raste individët e kanë më të vështirë të parashikojnë, të kuptojnë dhe të orientohen për veprimet ose mosveprimet që konsiderohen vepra penale dhe masat ndëshkuese përkatëse. Përveç sa më sipër, ligji konkret parashikon gjoba të cilat shkojnë përtej atyre që parashikon KP-ja, duke krijuar premisa për një cenim të së drejtës së pronës.

Në vlerësimin tim, delegimi i përgjithshëm që ka bërë ligjvënësi në paragrafin e dytë të nenit 1, shkronja "a" të KP-së, për përfshirjen e dispozitave penale edhe në ligje të tjera, dhe delegimi specifik që përmban paragrafi i katërt i nenit 45 të KP-së, për rregullimin me ligj të veçantë të veprave penale dhe masave ndëshkuese ndaj personave juridikë, nuk nënkuptojnë miratimin e dispozitave të reja penale me ligje të thjeshta. Këto dy lloj delegimesh kërkojnë domosdoshmërisht respektimin në çdo rast të parimeve të ligjshmërisë dhe të shtetit të së drejtës, të sanksionuara në nenet 4, 29, në lidhje dhe me nenin 81, pika 2 të Kushtetutës. Ndaj, çmoj se, miratimi i dispozitave penale, në rastin konkret, pa respektuar formalisht procedurën e parashikuar nga neni 81, pika 2, e Kushtetutës, nuk i përmbush kërkesat kushtetuese të shtetit të së drejtës dhe nuk është në përputhje me parimin e ligjshmërisë.

B. Për pretendimin e papajtueshmërisë me Kushtetutën të neneve 135 dhe 186 të Kodit Penal

Gjykata referuese ka kërkuar shfuqizimin e neneve 135 dhe 186 të KP-së, si të papajtueshme me

nenin 17/1 të Kushtetutës, për shkak të parashikimit të dy dënimeve kryesore për të njëjtën vepër penale. Shumica nuk e ka legjitimuar gjykatën referuese për këtë pretendim, duke ritheksuar edhe një herë interpretimin që gjykatat duhet t'i bëjnë vendimit nr. 47/2012, ku trajtohet një pretendim i ngjashëm, dhe duke arsyetuar se mbi bazën e këtij interpretimi dhe parashikimeve aktuale të KP-së gjykata referuese mund ta zgjidhte çështjen konkrete.

Në dallim nga shumica, vlerësoj se gjykata referuese legjitimohet për të vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, sipas objektit të kërkesës, por kërkesa duhej të rrëzohej për arsye se pretendimet për jokushtetutshmërinë e neneve 135 dhe 186 të KP-së, janë të pabazuara.

Shumica, në arsyetimin e saj, i është referuar vendimit nr. 47/2012, ku Gjykata, pasi ka shqyrtuar një pretendim të bazuar mbi të njëjtat argumente, ka shfuqizuar dispozitën penale të përgjithshme, që parashikonte dhënien e dënimit me burg dhe gjobë bashkërisht në rastet e parashikuara nga KP-ja (neni 29, paragrafi i fundit) dhe nenet 190 dhe 191, si dispozita penale të posaçme, të cilat parashikonin dënimin me gjobë, si dënim kryesor, krahas dënimit me burgim. Për pasojë, gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, sipas shumicës, për shkak të antikushtetutshmërisë së nenit 29, paragrafi i fundit të KP-së, nuk mund të aplikojnë njëkohësisht dy dënime kryesore në rastet kur këto dënime janë të parashikuara në dispozitat e Pjesës së Posaçme të KP-së *(paragrafi 15 i vendimit).* Ndërkaq, për të njëjtat argumente kushtetuese, si në rastin e vendimit nr. 47/2012, shumica jo vetëm nuk e legjitimon gjykatën referuese, por shkon më tej duke e orientuar atë se, në rastin objekt shqyrtimi, duhet të zbatojë vetëm dënimin me burgim, si dënim kryesor, dhe, sipas diskrecionit të saj, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 34, paragrafi i pestë e i gjashtë i KP-së, edhe dënimin me gjobë (*paragrafi 16 i vendimit*).

Në vështrim të sa më sipër, siç jam shprehur edhe në mendimin paralel të vendimit nr. 13, datë 16.4.2013, vlerësoj se vendimi nr. 47/2012, i kësaj Gjykate, në lidhje me kushtetutshmërinë e pjesëve të dispozitave penale të posaçme, ku parashikohet dënimi me gjobë krahas atij me burgim, ka krijuar paqartësi tek gjykatat e zakonshme, kur këto duhet të aplikojnë dënimin në raste konkrete, që rregullohen nga këto dispozita penale të posaçme. Kjo paqartësi reflektohet pikërisht në paraqitjen e kësaj kërkese nga gjykata referuese, duke pasur parasysh fuqinë detyruese të përgjithshme të vendimeve të Gjykatës.

Gjykata ka theksuar se është në diskrecionin e ligjvënësit vlerësimi i mjetit të zgjedhur për ndëshkimin e shkelësve të ligjit dhe qëllimit që kërkohet të arrihet por, kur është fjala për parashikimin e dispozitave penale dhe sanksioneve përkatëse si *"ultima ratio"*, ligjvënësi duhet të udhëhiqet nga parimet kushtetuese dhe funksionet që karakterizojnë dënimet penale. Gjykata vlerëson proporcionalitetin e masave penale në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat ato jepen. Ajo ka theksuar se proporcionalitetin e një kufizimi ajo e vlerëson rast pas rasti dhe duke pasur parasysh disa aspekte, si balancën mes së drejtës së kufizuar dhe interesit publik ose mbrojtjes së të drejtave të të tjerëve, mjetin e përdorur në raport me gjendjen që e ka diktuar atë, të drejtën e cenuar dhe synimin që kërkon të arrijë ligjvënësi, aspekte që nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Vendosja me ligj e llojit të dënimeve është përgjithësisht diskrecion i pushtetit legjislativ, i cili, në përputhje me kërkesat dhe me nevojat në ndryshim të shoqërisë, bën rregullimin ligjor përkatës, por Gjykata analizon proporcionalitetin e kësaj mase në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre (*shih vendimin nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

Siç jam shprehur me mendimin në pakicë, në vendimin nr. 47/2012, karakteri i drejtë ose jo i një dënimi nuk lidhet me numrin e efekteve të drejtpërdrejta apo anësore që ai mbart në vetvete, por me përputhjen e tij me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe të autorit të saj dhe se parimi i drejtësisë së dënimit nuk lidhet në korrelacion kaq të drejtpërdrejtë mes llojit të dënimit dhe veprës penale, por me sigurimin, brenda respektimit të dinjitetit njerëzor, të një baraspeshimi mes rëndësisë së masës ndëshkuese dhe rëndësisë së veprës penale. Neni 29 i KP-së nuk gjen zbatim *a priori* për çdo vepër penale, por ai gjen zbatim rast pas rasti, sipas parashikimeve specifike në dispozitat e KP-së që rregullojnë veprat e ndryshme penale. Vlerësimi nëse një dënim i caktuar penal, për shkak të kufizimit që përcakton në të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, është proporcional në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e atij dënimi, është një vlerësim që duhet bërë rast pas rasti, pas shqyrtimit të rrethanave konkrete të çështjes kushtetuese dhe pas marrjes në analizë të elementeve të

veprës penale përkatëse, shkallës së rrezikshmërisë dhe pasojave që vijnë nga ajo vepër penale.

Shumica, në arsyetimin e vendimit, nuk ka arritur të japë argumente që lidhen me mosplotësimin e kushtit të diktuar nga norma kushtetuese, i cili kërkon që masat e marra të jenë proporcionale në raport me gjendjen dhe me shkeljet për të cilat është parashikuar dhënia e tyre. Në këtë drejtim, shumica ka çmuar se përcaktimi i veprave penale dhe llojeve të dënimeve është në diskrecion të ligjvënësit, ndërsa individualizimi i tyre, rast pas rasti, është në diskrecion të gjykatës, e cila, duke shqyrtuar gjithë elementet juridike të veprës penale, shkallën e fajit dhe pasojat e ardhura nga vepra penale, cakton llojin dhe masën e dënimit për autorët e veprave penale. Duke pasur parasysh sa më sipër, duket se shumica nuk argumenton cenimin e kritereve kushtetuese për kufizimin e së drejtës, por, në thelb, i referohet parimit të ndarjes së pushteteve, pa analizuar se si cenohet ky parim në rastin në shqyrtim. Ndryshe nga sa argumenton shumica, gjykata nuk pengohet në rastin konkret për sa i përket individualizimit të dënimit për veprat penale të parashikuara nga nenet 135 dhe 186 të KP-së, përkundrazi, ajo ka një fushëveprimi të gjerë për caktimin e llojit dhe masës së dënimit në përputhje me dispozitat penale të sipërpërmendura.

Për më tepër, shumica nuk ka argumentuar arsyet kushtetuese për sa i përket orientimit që i jep gjykatave të juridiksionit të zakonshëm, sipas të cilit, në rastet e përmendura më sipër, ato të aplikojnë vetëm dënimin me burgim dhe, nëse plotësohen kriteret e parashikuara nga neni 34, paragrafi i pestë e i gjashtë i KP-së, edhe dënimin me gjobë. Përcaktimi i llojit të sanksionit duhet të bëhet nga ligjvënësi pozitiv. Kuvendi ka një hapësirë të gjerë vlerësimi për formulimin e sanksionit duke përcaktuar, krahas veprave penale, edhe llojin e masën e dënimit, në proporcion me rrezikshmërinë e veprës. Kjo i jep mundësinë gjyqtarit të japë një gjykim të drejtë dhe të caktojë një masë dënimi brenda kufijve të përcaktuar nga legjislacioni penal, duke e individualizuar dënimin brenda kësaj fushëveprimi.

Për sa më sipër, çmoj se pretendimi i ngritur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër për papajtueshmërinë e ligjit, objekt shqyrtimi, me nenin 81/2 të Kushtetutës, është i bazuar dhe, për rrjedhojë, kërkesa duhej pranuar me këtë argument.

Anëtar: Sokol Berberi

MENDIM PARALEL

Për arsye se ndaj mendim të ndryshëm në lidhje me argumentet për rrëzimin e *pretendimit të kërkueses për papajtueshmërinë e ligjit, objekt shqyrtimi, me nenin 81/2 të Kushtetutës,* çmoj të rëndësishme të dal me mendim paralel.

1. Gjykata referuese pretendon se ligji nr. 9754, datë 14.6.2007 "Për përgjegjësinë penale të personave juridikë", duhet të shpallet tërësisht në kundërshtim me Kushtetutën, për shkak se bie ndesh me parimin e shtetit të së drejtës. Sipas kërkueses, ky ligj është i papajtueshëm me nenet 4, 16/2, 29/1, 81/2, pika "d" të Kushtetutës, pasi është miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë me shumicë të thjeshtë, ndërkohë që duhej miratuar me një shumicë të cilësuar prej tri të pestave të të gjithë anëtarëve të tij.

2. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar se Kodi Penal përbën ligjin më të rëndësishëm, ku përfshihen në mënyrë të sistemuar dispozitat penalo-juridike. Një nga parimet kryesore që përshkon këtë Kod është edhe parimi i ligjshmërisë, që nënkupton parashikimin me ligj të veprave penale dhe mosdënimin për një vepër penale që nuk është parashikuar shprehimisht si krim ose kundërvajtje penale. Dispozita që e klasifikon një veprim të caktuar si vepër penale, jashtë dispozitave të Kodit Penal dhe si pjesë e një ligji të miratuar me shumicë të thjeshtë të deputetëve, bie ndesh me parimin e kushtetutshmërisë, pasi prek drejtpërdrejt shtetasit në të drejtat dhe liritë e tyre, duke mos respektuar shumicën e cilësuar për këtë qëllim, të parashikuar nga neni 81, pika 2 i Kushtetutës *(shih vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 3, datë 5.2.2010).*

3. Në referim të Kodit Penal, nenit 1/a, paragrafi i dytë, legjislacioni penal përfshin rregullimet e vetë Kodit dhe ligje të tjera penale. Për sa i përket zbatimit të legjislacionit penal ndaj personave juridikë, Kodi Penal, në nenin 45, parashikon se: "*Personat juridikë, me përjashtim të institucioneve shtetërore, përgjigjen penalisht për vepra penale, të kryera në emër ose në dobi të tyre nga organet dhe përfaqësuesit e tyre...Veprat penale dhe masat ndëshkuese përkatëse, që zbatohen ndaj personave juridikë, si dhe*

procedura për vendosjen dhe ekzekutimin e tyre rregullohen me ligj të veçantë”.

4. Siç rezulton nga normat e mësipërme të KP-së, si ligj i cilësuar, ligjvënësi ka deleguar mundësinë e parashikimit, në një ligj të veçantë, të masave ndëshkuese për veprat penale që mund të kryejnë personat juridikë. Këto subjekte mbajnë përgjegjësi penale për një kategori të caktuar veprash penale, të cilat janë të përcaktuara shprehimisht në normat e KP-së dhe që i përshtaten natyrës së tyre. Në këtë kuptim, ndaj të njëjtin mendim me shumicën se ligji, objekt kundërshtimi, nuk ka krijuar vepra të reja penale që duhen zbatuar ndaj personave juridikë. Ndërhyrja e ligjvënësit është kufizuar vetëm në rregullimin e llojit dhe masës së dënimit për vepra penale konkrete, të cilat janë vetëm ato të parashikuara nga KP-ja.

5. Bazuar në standardet kushtetuese, natyrën deleguese të parashikimeve të nenit 1/a të KP-së, si dhe në karakteristikat e përcaktimeve të nenit 45 të tij, mendoj se është e panevojshme analiza mbi plotësimin e kriterit të kuorumit prej “tri të pestave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit”, në referim të nenit 81/2 të Kushtetutës. Për rrëzimin e pretendimit të gjykatës referuese ishte i mjaftueshëm konstatimi i shumicës se ligji, objekt kundërshtimi, plotëson kërkesat e parimeve të ligjshmërisë dhe të kushtetutshmërisë.

Anëtare: Vitore Tusha